

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar kontributin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje;

Duke njohur misionin e Autoritetit për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv, që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2021 në drejtim të:

Monitorimit të vazhdueshëm të treguesve të likuiditetit të shoqërive të sigurimit duke kërkuar pezullimin e shpërndarjes së dividendit edhe për vitin 2021, masë që ndikoi në ruajtjen e treguesve financiarë për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe aktiveve në mbulim të provigjioneve teknike.

Implementimit të ligjeve të reja të tregut të sigurimeve, kapitalit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive nëpërmjet plotësimit dhe përafrimit të një pjese të konsiderueshme të kuadrit ligjor dhe rregullator të tregjeve nën mbikëqyrje, nëpërmjet të cilave janë shtuar mundësitë dhe janë diversifikuar hapësirat për zgjerimin e pranisë së kompanive ndërkombëtare.

Përfundimit të procesit të hartimit të projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, duke marrë në konsideratë praktikat më të mira evropiane, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu.

Digjitalizimit dhe përmirësimit të sistemeve të raportimit, të cilat kanë çuar në përmirësimin e aksesit të shërbimeve për qytetarët dhe rritjen e efektivitetit në proceset mbikëqyrëse nëpërmjet integritetit të plotë të shërbimeve që lidhen me sigurimin e detyrueshëm të automjeteve në portalin *e-Albania*, zhvillimit të aplikacionit të llogaritësit të dëmeve ndaj personit në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike dhe aksesimit të tij në faqen zyrtare të AMF-së, si dhe përmirësimit të sistemit të raportimit për tregun e sigurimeve me versionin më të ri, duke shtuar funksionet dhe raportet analitike në kuadër të proceseve mbikëqyrëse.

Mbikëqyrjes efektive të tregjeve financiare jobankare, duke vijuar me realizimin e 30 inspektimeve *onsite*, si dhe realizimin e 23 verifikimeve të thelluara për bankat, shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, depozitarët dhe fondet e investimeve në kuadër të përshtatshmërisë që duhet të përmbushin subjektet që operojnë në këto tregje sipas kërkesave të reja të legjislacionit.

Angazhimit dhe kontributit të dhënë lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të adresuara në raportin e MONEYVAL-it jo vetëm nëpërmjet realizimit të 9 inspektimeve pranë 4 shoqërive të sigurimit të jetës dhe risigurimit, 2 bankave që ushtrojnë veprimtarinë e kujdestarisë, 2 shoqërive administruese dhe një agjenti në sigurime, por edhe forcimit të kapaciteteve administrative të institucionit nëpërmjet organizimit në bashkëpunim me FMN-në, Këshillin e Evropës, IOSCO-n, GIZ-in, të një sërë trajnimesh për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Marrjen e 34 vendimeve për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, nga të cilat 26 për tregun e sigurimeve, 4 për tregun e kapitalit dhe 4 për tregun e fondeve të pensionit vullnetar, të cilat kanë sjellë arkëtimin e vlerës prej 7.1 milionë lekësh si të ardhura nga gjobat.

Ofrimit të trajnimeve në kuadër të edukimit në vazhdim dhe kualifikimit profesional me vlerësuesit e dëmeve dhe brokerat në tregun e sigurimeve, të cilat kanë pasur në fokus njohjen

dhe zbatimin në praktikë të ligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, si edhe rregullores së re për llogaritjen e masës së dëmshpërblimit, hartuar në zbatim të këtij ligji.

Shqyrtimit dhe trajtimit nëpërmjet regjistrimit *online* të një numri total prej 221 ankesash të konsumatorëve dhe investitorëve, nga të cilat 214 ankesa i përkasin tregut të sigurimeve, më së shumti sigurimit të detyrueshëm motorik dhe sigurimit të pronës, dhe zgjidhjes me marrëveshje mes palëve të 128 ankesave.

Zgjerimit të bashkëpunimit me autoritetet homologe dhe evropiane, nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit me Agjencinë Kroate të Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA), në shkurt 2021, dhe marrjes pjesë në takimet e organizuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN) dhe nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (FMA). Përfuturit të asistencës së vazhdueshme të organizatave ndërkombëtare, si: FMN, IOSCO dhe IOPS për zhvillimin e kapaciteteve jo vetëm të stafit të institucionit, por edhe të operatorëve të tregut financiar jobankar.

Edukimit të vazhdueshëm të përdoruesve të shërbimeve financiare, duke përfshirë dhënien e informacionit përkatës në faqen e internetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet që lidhen me investimet në instrumente financiare për të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të mbikëqyrura dhe përdoruesve të shërbimeve të tyre nëpërmjet trajnimit *online* për vlerësues dëmsh në sigurime të 112 pjesëmarrësve.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2022 të angazhohet në këto drejtime:

Të avancojë më tej punën për miratimin e projektligjit “Për fondet e pensioneve private” brenda vitit 2022, si dhe të përfundojë pjesën e mbetur të kuadrit rregullator dhe procesit të përshtatshmërisë së subjekteve me ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe fondeve të investimit.

Të miratojë brenda vitit 2022 aktet rregullatore, në zbatim të ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, si dhe të intensifikojë bashkëpunimin me autoritetet rregullatore ndërkombëtare për marrjen e eksperiencave më të mira për këtë treg.

Të vazhdojë angazhimin për përmbushjen e rekomandimeve të MONEYVAL-it, në drejtim të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe të intensifikojë bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë dhe Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave për realizimin e inspektimeve të përbashkëta.

Të nxisë zhvillimet e tregjeve nën mbikëqyrje në drejtim të krijimit të produkteve dhe shërbimeve inovative.

Të ketë prioritet forcimin e mëtijshëm të funksionit mbikëqyrës dhe përafrimin me standardet më të mira ndërkombëtare, si dhe të vijojë monitorimin e kujdesshëm të treguesve kryesorë financiarë të subjekteve nën mbikëqyrje, duke marrë në konsideratë mundësinë e efekteve të vonuara nga pandemia.

Të nxisë shkëmbimin e informacionit rajonal në funksion të mbikëqyrjes efektive të aktivitetit të grupeve të sigurimit.

Të monitorojë zhvillimet e tregjeve të mbikëqyrura në drejtim të rritjes së transparencës për produktet që iu ofrohen investitorëve.

Të marrë parasysh rekomandimet e KLSH-së dhe audituesit të pavarur, duke nisur procesin e rishikimit të ligjit.

Të vijojë inspektimet me bazë rreziku në tregjet e mbikëqyrura dhe të raportojë në mënyrë të vazhdueshme në Kuvend, si dhe të paraqesë në Kuvend, së bashku me raportin vjetor, informacion për vendimet e ankimuara të Bordit.

Të vazhdojë angazhimin për implementimin e strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare, përmirësimit të eficiencës së tregut dhe zgjerimit të bazës së investitorit, në bashkëpunim me institucionet me rol kyç për zhvillimin e tregut, si dhe me aktorët e tregut ose institucionet ndërkombëtare.

Të vazhdojë punën për vlerësimin e përputhshmërisë me Parimet Themelore Ndërkombëtare në Sigurime (*Insurance Core Principles* - ICP), me qëllim avancimin drejt standardeve më të mira ndërkombëtare.

Të zhvillojë udhërrëfyesin në kuadër të përafrimit me regjimin evropian Solvency II, si dhe të rishikojë kornizën rregullatore në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve të sigurimeve.

Miratuar në datën 9.6.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla